



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE KONSULTIMIN PUBLIK

Nr. 757/1 prot.

Tiranë më 11.03.2026

PLANI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 33, DATË 31.03.2022
“PËR TË DHËNAT E HAPURA DHE RIPËRDORIMIN E INFORMACIONIT
TË SEKTORIT PUBLIK” NGA ORGANET E SEKTORIT PUBLIK

Në zbatim të Programit të Punës së Zyrës së Komisionerit për vitin 2026 dhe referuar fushës së përgjegjësisë së Drejtorisë për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik në Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, miratohet plani i monitorimit për vitin 2026 të organeve të sektorit publik përgjegjëse për kategorinë e të dhënave me vlerë të madhe “mjedisore dhe vëzhgimit të tokës”, si më poshtë:

1. Verifikimi i publikimit të “Listës së dokumenteve që mund të ofrohen në formatin e të dhënave të hapura” në faqen e parë/kryesore të web-it të organit të sektorit publik;
2. Verifikimi nëse të dhënat/dokumentet e publikuara janë në formatet e hapura (machine readable);
3. Verifikimi i publikimit të “Licencës standarde”, në formatin elektronik, sipas modelit të miratuar me Udhëzimin e përbashkët nr. 2, datë 6.2.2025 “Për miratimin e licencës standarde të ripërdorimit të informacionit të sektorit publik”;
4. Verifikimi i publikimit të tarifave të miratuara, për rastet kur aplikohen tarifa për të drejtën e ripërdorimit të të dhënave të hapura, parashikuar në legjislacionin e posaçëm;
5. Verifikimi nëse të dhënat janë publikuar edhe në portalin opendata.gov.al;
6. Hartimi i rekomandimeve në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të mësipërme.

Përzgjedhja e këtyre organeve publike dhe kësaj kategorie të dhënash është bërë bazuar në parashikimet e nenit 16 të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” dhe rëndësisë që kanë këto të dhëna të hapura për shoqërinë, mjedisin dhe ekonominë, veçanërisht në krijimin e shërbimeve dhe të aplikacioneve me vlerë të shtuar, hapjen e vendeve të punës të përshtatshme dhe me cilësi të lartë, si dhe për shkak të numrit të përfituesve të mundshëm të shërbimeve dhe aplikacioneve me vlerë të shtuar të bazuara në këto grupe të dhënash.

Shqyrtimet administrative mund të fillojnë kryesisht edhe ndaj çdo organi tjetër të sektorit publik i cili nuk është në listën bashkëlidhur, por gjatë punës rezulton se veprimtaria e tij përfshin të dhëna mjedisore dhe vëzhgimit të tokës.

Plani i monitorimit ka për qëllim përmbushjen e kompetencës së “mbikëqyrjes” parashikuar në nenin 19 të ligjit 33/2022 dhe publikohet në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit.

Drejtoria për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik ngarkohet të hartojë raport monitorimi në përfundim të këtij procesi.

Bashkëlidhur lista e organeve të sektorit publik të cilët do i nënshtrohen procesit të monitorimit për vitin 2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

**Plani i monitorimit online për vitin 2026 i Drejtorisë për të Dhënave të Hapura dhe Konsultimin Publik,
në Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit**

Nr.	Objekti	Procedurat objekt i monitorimit	Organi i Sektorit Publik	Njësia përgjegjëse	Periudha	Lloji i aktivitetit
1.	Monitorimi i zbatimit të ligjit nr. 33 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” dhe akteve të dala në zbatim të tij, nga Organet e Sektorit Publik që janë përgjegjës për të dhënat me vlerë të madhe “mjedisore dhe vëzhgimit të tokës”	Procesi do të fillojë me informimin e OSP-ve që do të monitorohen.	Ministria e Mjedisit	Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit	Gjatë vitit	Monitorim
2.			Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)		Gjatë vitit	Monitorim
3.			Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)		Gjatë vitit	Monitorim
4.			Agjencia Kombëtare e Pyjeve		Gjatë vitit	Monitorim
5.			Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve		Gjatë vitit	Monitorim
6.			Zyra e Administrimit të Parkut Kombëtar “Lumi i Vjosës”		Gjatë vitit	Monitorim
7.		I gjithë procesi do të realizohet nëpërmjet monitorimit online me qëllim mbledhjen e informacionit, njohjen e situatës dhe evidentimin e mangësive/problematikave, nëse ka, që do të shërbejnë për të ndërhyrë më tej për të përmirësuar situatën e konstatuar në çdo fazë të procesit.	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)	Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit	Gjatë vitit	Monitorim
8.			Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural		Gjatë vitit	Monitorim
9.			Agjencia e Menazhimit të Burimeve Ujore (AMBU)		Gjatë vitit	Monitorim
10.			Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)	Drejtorinë e të Dhënave të Hapura dhe Konsultimin Publik	Gjatë vitit	Monitorim
11.			Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)		Gjatë vitit	Monitorim
12.			Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit (AKPT)		Gjatë vitit	Monitorim
13.			Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB), Fushë Krujë		Gjatë vitit	Monitorim
14.			Drejtorinë e Përgjithshme Detare		Gjatë vitit	Monitorim
15.			Instituti i Gjeoshkencave		Gjatë vitit	Monitorim
16.			Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)		Gjatë vitit	Monitorim
17.			Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC)		Gjatë vitit	Monitorim
18.			INSTAT -Instituti i Statistikave		Gjatë vitit	Monitorim